



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 6321/1 prot

Fier, më. 14.06.2025

NJOFTIM PER DEGJESE PUBLIKE

BANOREVE TE KOMUNITETIT TE FIERIT DHE GJITHE PALEVE TE

INTERESUARA

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", në nenin 9, pika 1.3, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 18, në rregulloren e Këshillit Bashkiak për konsultimet publike

Ju njoftojmë se do të zhvillohen dëgjesa publike, në kuadër të:

Propozimit të ZVA-së Fier për krijimin e shkollave të bashkuara dhe emërtimin e tyre:

1. Bashkimin e gjimnazit «Jovan Ndreko» Libofshë me shkollën 9-vjeçare «Anastas Laska» Libofshë për të krijuar shkollën e Bashkuar.

2. Bashkimin e gjimnazit «Kutbi Vruzhaj» Levan me shkollën 9-vjeçare «Dino Ismaili» Levan për të krijuar shkollën e Bashkuar.

Ftojme të gjithë grupet e interesit si qytetarë, (nxënësit e shkollave, mësuesit, prindër) grupet e marginalizuara, të rinj/të reja, shoqëri civile të bëhen pjesë e kësaj dëgjese për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Takimi do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Nr	Takimi	Dita e takimit	Data e takimit	Vendi	Ora
1	Libofshë	E Premte	11.07.2025	Qënder	10:00
1	Levan	E Premte	11.07.2025	Qënder	14:00

Ky takim ka si qëllim kryesor bashkëpunimin dhe mbledhjen e rekomandimeve të cilat do të shërbejnë për orjentimin në hartimin e materialit për **krijimin e shkollave të bashkuara dhe emërtimin e tyre**

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete të cilat mund të dërgohen në adresat e mëposhtme të emailit :

Meritan.Bocova@bashkiafier.gov.al Kordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Këto dëgjesa do të zhvillohen në bashkëpunim me Bashkinë dhe , Antarë / përfaqësues të Këshillit Bashkiak Fier,

Jeni të lutur të merrni pjesë pasi pjesmarrja juaj është shumë e rëndësishme !

KRYETARI
Armando SUBASHI

NE MUNGESHE DHE ME URDHER

Zv.Kryetar
Suela Prifti

